LIGJ
Nr. 78/2016

PËR ZHVILLIMIN DHE PJESËMARRJEN E FORCAVE USHTARAKE TË BRITANISË SË MADHE NË STËRVITJEN E PËRBASHKËT "ALBANIAN LION 2016"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave ushta-rake të Britanisë së Madhe në stërvitjen e përbashkët "Albanian Lion 2016", në kuadër të bashkëpunimit dypalësh.

Neni 2

Lejimin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të 1 500 (një mijë e pesëqind) trupave ushtarake të Britanisë së Madhe, pjesëmarrës në stërvitje.

Neni 3

Qëllimi i kësaj stërvitjeje është realizimi i operacioneve joluftarake të evakuimit, nëpërmjet detit dhe ajrit, duke përfshirë anije luftarake zbarkuese, helikopterë dhe forca speciale për veprimtaritë në tokë.

Neni 4

Stërvitja "Albanian Lion 2016" zhvillohet në periudhën 17 shtator – 8 tetor 2016, në gadi-shullin e Karaburunit, ishullin e Sazanit, bazën e Porto-Palermos, bazën ajrore Kuçovë dhe Rinas, Bizë, kepi i Palit, Zall-Herr, si dhe në rrugëka-limet ajrore e tokësore për në këto rajone.

Neni 5

Në këtë stërvitje angazhohen 1 500 (një mijë e pesëqind) trupa ushtarake të Britanisë së Madhe, 4 (katër) anije luftarake 1 (një) helikoptermbaj-tëse, 1 (një) fregatë dhe 2 (dy) anije zbarkuese, 3 (tre) avionë ushtarakë HAWK Jets dhe 10 (dhjetë) helikopterë, 2 Chinook, 4 AH64, 2 Marlin Mk2, 2 (WILDCAT), të cilët do të kryejnë lëvizje gjatë 24 orëve në rajonin e përcaktuar të stërvitjes, sipas nenit 4, të këtij ligji.

Neni 6

Trupat britanikë, gjatë hyrjes, qëndrimit dhe daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë, do të kenë statusin e parashikuar në marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave të tyre, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, dhe të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 10 101, datë 26.3.2009.

Neni 7

Gjatë hyrjes, qëndrimit e daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë, trupat britanikë do të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 8

Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Financave dhe

ministri i Transportit dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij ligji.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 25.7.2016

Shpallur me dekretin nr. 9711, datë 1.8.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani